



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GAZETARISË DHE KOMUNIKIMIT



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gazetari**

**Lënda: SISTEMI FINANCIAR**

<i>Pedagogu:</i>	Prof. Asoc. Dr. Adriatik KOTORRI
<i>Ngarkesa:</i>	3 ETCS (15 javë: 2 leksione në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	E detyruar
<i>Viti/semestri:</i>	II/II

**Përshkrimi:** Është një disiplinë në fushën e financës e cila synon të pajisë studentët me njohuri strukturore për sistemin financiar si dhe njohuri bazike për instrumentet dhe institucionet që veprojnë në sistemin financiar. Objektivi i lëndës është të aftësojë studentët në lidhje me sistemin financiar si në sektorin veçantë të ekonomisë, me njohjen e institucioneve financiare pjesë të tij si dhe problematikave dhe krizave që ndesh sistemi financiar. Në përfundim të kësaj lënde studentët do të mund të dallojnë dhe kuptojnë informacionet që lidhen me bankat tregtare, kompanitë e sigurimit, planet e pensionit, fondet e përbashkëta, kompanitë e lizingut, tregjeve dhe instrumenteve financiare etj. Gjithashtu rëndësishme është përgatitja e tyre për të njohur institucionin e Bankës Qendrore dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave së bashku me rolin që këta mbikëqyrës kanë në ekonomi.

**Temat e leksioneve:**

- TEMA 1: Hyrje në sistemin financiar, struktura financiare, institucionet financiare, tregjet financiare.
- TEMA 2: Sistemi financiar dhe ekonomia reale, të ardhurat dhe shpenzimet korrente dhe kapitale, pasuria reale dhe pasuria financiare, kursimi dhe investimi, etj.
- TEMA 3 : Karakteristikat e sistemit financiar, asimetria e informacionit, zgjedhja e keqe dhe risku i ndërjegjes, krizat financiare.
- TEMA 4: Financa informale, ekonomia informale, bankingu informal, avantazhet dhe disavantazhet e informalitetit.
- TEMA 5: Performanca e sistemit financiar, indikatorët e matjes së performancës së një sistemi financiar, indeksi i lirisë ekonomike, etj.
- TEMA 6: Normat e interesit dhe tregu i huasë, koncepti i normave të interesit, kërkesa dhe oferta për hua, faktorët që ndikojnë në ndryshimin e normës së interesit, efekti i Fisherit.
- TEMA 7: Ndikimi i riskut në Norma e interesit; risku i inflacionit, kredisë, likuiditetit, tatimor dhe afatit të maturimit; kurbat e normave të interesit dhe teoritë e përcaktimit të tyre.
- TEMA 8: Veprimtaria bankare, depozituesit dhe huamarrësit, karakteristikat e depozitave dhe huave, transformimi bankar.
- TEMA 9: Bilanci i bankave, aktivi dhe pasivi bankar, kapitali dhe roli i tij në bankë, aktivi fikse dhe roli i tij në bankë.
- TEMA 10: Fitimi i bankës dhe performanca, të ardhurat dhe shpenzimet e bankës, marzhi i ndërmjetësimit bankar, ROE dhe ROA e biznesit bankar, raportet e performancës bankare.
- TEMA 11: Banka qendrore, historiku dhe funksionet e bankës qendrore, pavarësia e bankës qendrore, bilanci i bankës qendrore, Banka e Shqipërisë.

TEMA 12: Paniku bankar dhe sigurimi i depozitave, koncepti i panikut bankar, etapat e panikut bankar, sigurimi i depozitave, Agjencia e Sigurimit të Depozitave, ligji shqiptar dhe ASD në Shqipëri.

TEMA 13: Lizingu, koncepti, format e lizingut, ndryshimi me alternativat e tjera të financimit, kompanitë e lizingut.

TEMA 14: Faktoringu, koncepti, format e faktoringu, risku i faktoringu, kompanitë e faktoringu në Shqipëri.,

TEMA 15: Risku financiar në ekonominë shqiptare, koncepti i riskut financiar, evoluimi i riskut financiar përgjatë tranzicionit ekonomik në Shqipëri pas vitit 1992.

#### **Forma e kontrollit dhe vlerësimit**

- *Detyrim frekuentimi në:*70% të leksioneve

- *Angazhimi në leksione:*

10% e notës

- *Testi I:* në javën e 7-të

20% e notës

- *Konrolli përfundimtar:* provim me shkrim

70% e notës

- Gjithsej:

100%

#### **Literatura e detyrueshme për studentin:**

1. Sistemi Financiar, cikël leksionesh, A. Kotorri, A. Korbi.

#### **Literatura plotësuese:**

1- Financial markets and institutions, Fabozzi, Modigliani, 2004.

2 - Corporate Finance, Brealey, Myers, Allen, 2006.

3 - Financial Management, Brigham, Erhardt, 2003.